

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KOMUNA E PODUJEVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit - Nr. i AP: **615-25-5439-1-1-1**

Sa i përket tenderit për: **Furnizim për blegtori(Subvencione për blegtori) Furnizim me mëshqera Llot-1**

A N K E S Ë

Identifikimi i ankuesit*

_____ **OE “Apetit SH.P.K.”** _____
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

_____ **Magjistralla Prishtinë-Mitrovicë KM11** _____
(Adresa)

_____ **OBILIQ** _____
(Vendi)

_____ **15000** _____
(Kodi postar)

_____ **+383 44213200** _____
(Numri Telefonit)

_____ _____
(Numri i Faks-it)

_____ **AVNI FERIZI** _____
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

_____ **info@apetitgroup.com** _____
(Adresa elektronike)

_____ **29.08.2025** _____
(Data e parashtrimt të ankesës)

_____ _____
(Nënshkrimi dhe vula)



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me tenderin: **Furnizim për blegtori(Subvencione për blegtori) Furnizim me mëshqera Llot-1**

Njoftimi për kontratë është bërë me datën 18.06.2025 ndërsa hapja publike është bërë më 08.07.2025.

Të pakënaqur me këtë vendim dhe brenda afatit të rregullt kohorë me datë 19.08.2025 iu kemi drejtuar AK-së me Kërkesë për Rishqyrtim.

AK me date 19.08.2024 e ka refuzua kërkesën tone andaj te pakënaqur me këtë vendim po i drejtohem OSHP-se me ankesë.

Kriteri i dhënies ka qenë: **Tenderi i Përgjegjshëm me Çmim më të ulët.**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

Hapja e tenderëve është bërë në datën 08.07.2025. Në procesverbalin e hapjes së tenderëve nuk ishte evidentuar ndonjë vërejtje apo shkelje ligjore.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Njoftimi për kontratë është bërë me datën 18.06.2025 ndërsa hapja publike është bërë më 08.07.2025.

Të pakënaqur me këtë vendim dhe brenda afatit të rregullt kohorë me datë 19.08.2025 iu kemi drejtuar AK-së me Kërkesë për Rishqyrtim.

AK me datë 19.08.2024 e ka refuzua kërkesën tone andaj te pakënaqur me këtë vendim po i drejtohem OSHP-se me ankesë.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK gjatë zhvillimit të kësaj procedure ka shkelur këto dispozita të LPP-së:

AK ka shkelur nenin 1 dhe 6 të LPP-së Nr. 04/L-042 dhe nenin 4 të RRPP-001/2022,

AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së Nr. 04/L-042,

AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së Nr. 04/L-042,

AK ka shkelur nenin 60 të LPP-së Nr. 04/L-042,

AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së Nr. 04/L-042,

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së.

Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

1. AK ka shkelur nenin 1 dhe nenin 6 të LPP-së pasi që gjatë procesit të vlerësimit të ofertave dhe administrimit me procedurën e prokurimit, nuk ka luajtur rol aktiv për të siguruar që fondet publike po shfrytëzohen në mënyrë më të drejtë, efikase dhe efektive. Kjo ka ardhur si pasojë e mos respektimit në mënyrë të drejtë dhe objektive të kërkesave dhe kriterëve të parapara me Njoftimin për Kontratë si dhe në Dosjen e Tenderit. Më saktësisht AK pa të drejtë na ka eliminua nga konkurrenca edhe pse i kemi plotësuar të gjitha specifikimet teknike të kërkuar nga AK. Bazuar në nenet e cekura më lartë si dhe bazuar në nenin 4.1.c të RRPP-001/2022 AK duhet të luaj rol aktiv në shpenzimin e parasë publike në mënyrë efikase, dhe efektive përkatësisht duhet që detyrimisht të sigurohet që çmimi i kontraktuar të jetë çmim normal i tregut. Me vet faktin që AK po kontraktonte një OE i cili nuk është i përgjegjshëm, tregon që po rrezikon shumë në realizimin e mirëfilltë të këtij projekti. Ne edhe pse kemi tejkaluar buxhetin për një vlerë shumë minore, ligji nuk e detyron AK-në që të mos e shtoj atë dhe gjithsesi nuk ja lejon që të kontrakttoj një tenderues të papërgjegjshëm vetëm pse e posedon çmimin brenda buxhetit. Buxheti i parashikuar ka qenë shumë i ulët në krahasim me çmimin e tregut dhe arsyeja pse OE i shpallur fitues ka ofertë brenda buxhetit është se ai është i papërgjegjshëm dhe dyshimi është i lartë për mos implementim të plotë të projektit. I njëjti as edhe një herë të vetme nuk ka realizuar një kontratë të tillë në të kaluarën prandaj kjo e rritë edhe më shumë rrezikun dhe shkeljen e AK në kontraktim të këtij OE.

Bazuar në këtë që e thamë më lartë, konstatohet lehtë se AK ka shkelur plotësisht nenin 1 dhe nenin 6 të LPP-së si dhe nenin 4 të RRPP-001/2022 gjatë vlerësimit të tenderëve duke mos vlerësuar tenderët në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit përkatësisht kërkesat e pikës 3.1 dhe 9.1 të FDT-së..

2. AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit të tenderëve na ka diskriminuar neve duke na eliminuar nga konkurrenca edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit. Këtë e themi sepse tenderi jonë i plotëson kërkesat e përshtatshmërisë ekonomike

dhe profesionale si dhe specifikimet teknike saktë ashtu siç janë kërkuar tek dosje të tenderit përkatësisht tek Aneksi 1 i sajë andaj edhe pse kemi tejkualuar buxhetin për më pak se 1.5% nuk do të thotë se jemi të përgjegjshëm dhe se nuk do të thotë që AK duhet shpërblyer me kontratë një OE i përgjegjshëm vetëm pse është brenda buxhetit të parashikuar. Mos kontestimi i referencave dhe mungesës së deklaratës mbi specifikimet teknike të OE që e ka shpallur fitues, të cilat kanë qenë kërkesa decideve dosjes së tenderit përkatësisht DNDF-së, shtyjnë AK-në drejt shkeljes së plotë të nenit 7 të LPP-së dhe favorizimit të hapur të këtij OE. Nëse AK nuk ka dashur të shtoj buxhet për të na shpallur neve si fitues atëherë është dashur ta anuloj tenderin e jo ta shpall fitues një tenderues të përgjegjshëm me mangësi të mëdha, pa përvojë në fushën adekuate që përbën rrezik të madh për dështim të kontratës. Sipas asaj që e thotë neni 7 i LPP-së, kjo konsiderohet trajtim jo i barabartë i tenderuesve përkatësisht diskriminim i hapur i tenderit tonë e që njëherit konsiderohet shkelje e pastër e kësaj dispozite ligjore. Detalisht për secilin gabim të AK përkatësisht të komisionit të vlerësimit që kanë bërë gjatë këtij procesi të vlerësimit, do ju njohim në pretendimin në vazhdim.

4. AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit nuk i ka respektuar kërkesat e veta nga dosja e tenderit respektivisht nga Aneksi 1 i sajë ashtu siç ishin përcaktuar paraprakisht. Neni 59.4 i LPP-së shumë qartë e përcakton se:

Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Në rastin konkret AK na ka eliminuar për gjoja se e kemi tejkualuar buxhetin edhe pse askund në asnjë dispozitë ligjore nuk thuhet se një OE është i përgjegjshëm vetëm pse ka tejkualuar buxhetin e parashikuar nga AK. Pikërisht për këtë nenin 62 i LPP ia jep si mundësi anulimin e tenderit kur të gjithë tenderuesit e përgjegjshëm tejkalojnë buxhetin po nuk e detyron në asnjë mënyrë që ta anuloj për një tejkallim për më pak se 1.5% të vlerës së parashikuar.

Ja si duket arsyetimi i AK-së për eliminim të tenderit tonë:

[Tenderi i juaj] është administrativisht i papërgjegjshëm:

ARSYETIM

[Tenderi i juaj është refuzuar] për këto arsye :

1. Koni tejkualuar buxhetin e paraparë nga komuna e Podujevës. Vlera e parashikuar e këtij projekti ka qenë 429,300.00€, ndërsa oferta e dërguar nga ana juaj është 435,456.00€. Pra, është tejkualur buxheti për 6,156.00€

Pra cilësimi i tenderit tonë si i papërgjegjshëm është i jashtëligjshëm sepse asnjë nga dispozitat ligjore nuk e mbështet këtë konstatim të AK prandaj edhe cilësohet me të drejtë si i pabazuar. Marrë për bazë faktin që ky parashikim është bërë në tetor të vitit 2024 ndërsa tani në vitin 2025 kanë ndryshuar(janë rritur) çmimet e tregut në masë të madhe, tregon se AK është dashur të shtoj buxhet e jo të na eliminoj për një element kaq minor. Asnjë dispozitë ligjore nuk e bënë të përgjegjshëm një OE nëse ka tejkualuar buxhet sidomos kur shihet se

AK ka planifikuar buxhetin në mënyrë shumë të gabuar.

AK ka bërë shkelje të nenit 59 të LPP-së edhe kur e ka konsideruar të përgjegjshëm OE që më pas e ka shpallur edhe fitues. Arsyeja pse mendojmë kështu është sepse ky OE posedon mangësi të theksuara në tenderin e tij.

Si mangësi e parë konsiderohet mungesa e deklaratës mbi specifikimet teknike të artikujve që kërkohen, e cila si kërkesë ka qenë decidive dhe e vendosur tek FDT në pikën 3.1. Ja si duket kërkesa e tillë:

Specifikacionet teknike të detyrueshme	3.1	Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentet dëshmoese për qëllimin e ofruar të kontratës, duke përfshirë: a. Deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara të cilat përpulhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit.
--	-----	---

Këtë deklaratë nuk e ka dorëzuar OE i shpallur fitues andaj me të drejtë do duhej konsideruar i papërgjegjshëm. Deklarata e tillë është e domosdoshme sidomos kur dihet natyre e artikujve që do liferohen dhe për të cilët është e pamundur të bëhet një hartim i detajuar i specifikimeve teknike. Pra mungesa e deklaratës së tillë e bënë të papërgjegjshëm OE në fjalë.

Mangësia tjetër e këtij OE është se nuk ka arritur ta plotësoj si duhet kërkesë për projektet e realizuara nga e kaluara. Ka paraqitur një listë të projekteve por të gjitha janë shitje tek blerës privat e shpesh edhe persona fizik, për të cilat nuk asnjë kontratë adekuate e as ndonjë referencë përkatëse. Kontratat dhe referencat janë të gjitha për shitje të kafshëve për mish(therje) e jo për kafshë apo lopë riprodhuese. Mungesa e kontratave adekuate dhe e referencave e bënë këtë OE të papërgjegjshëm. Kërkesa e AK për këtë kriter ishte e vendosur kështu:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe profesional Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjajshme, furnizime, në 3 (tre) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë), në vlerë minimale prej 643950,00për Llot-1	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> Operatori Ekonomik duhet të ofroj listën e kontratave të nënshkruar dhe të vulosur. Në listë duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të furnizimeve, duke plotësuar Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të punëve
---	-----------	--	--

Sipas kësaj AK ka lënë mundësin që projektet të mbulohen edhe me certifikatat për kryerjen e punëve por në rastin e këtij OE nuk është paraqitur asnjë raport apo dëshmi që dikush ka pranuar ndonjë artikull(lopë) përveç që ka dorëzuar fatura të lëshuara dhe të nënshkruara ku me anë të tyre nuk mund të dëshmohet realizimi i furnizimeve. Paraqitja e pagesave dhe transfereve bankare dëshmon realizimin e pagesës por jo edhe liferimin e artikujve prandaj nuk është dëshmi që verifikon shumë saktësinë e liferimeve.

Përpos kësaj të gjithë artikujt janë të shitur me njësi matëse KG, që tregon qarë se nuk janë

lopë riprodhuese por janë kafshë të shitura për therje. Ja si duket një faturë e tillë:



"MELI" SH.P.K

Fatura Për: **SALLAHAJ S SH.P.K.**

Nr. unik/fiskal: 811976507 /

Nr. biznes/bvsh: /

Kontakti: 38345574411

Adresa: Çiflak, Rruga Tahir Sinani, P.N.
21000, RAHOVEC - KS

Fatura



97-210-001-25

Vlera e mbetur: **6,000.00**

Gjashte mije

Njësia Org.	Data e faturës	Afati për pagesë	Referenca	Referenti i juaj	Kushtet					
DEPO KRYESORE	19.02.2025	01.03.2025			NET 10					
Nr	Shifra	Përshkrimi	Sasia	Njësia	Çmimi pa Tvsh	Rabati (%)	Tvsh %	Çmimi me rabat	Çmimi shitës	Vlera shitëse
1	108	LOP PER RIPODHIM NE COPA	3.00	CP	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
2	109	LOP PER RIPODHIM NE KG	2,580.00	KG	2.33	0.00	0.00	2.33	2.33	6,000.00
Total:										6,000.00 EUR
Vlera pa rabat:										6,000.00 EUR
Rabati:										0.00% 0.00 EUR
Rabati shitesë:										0.00% 0.00 EUR
Tvsh:										0.00% 0.00 EUR
Vlera për pagesë:										6,000.00 EUR

NL965218830
NL712920146
NL766440467



Fatura

VËREJTJE :GJATË PAGESES TË SPECIFIKOHET NUMRI I FATURES



Rr: Armend Daci nr13/1
10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 45 581 580

Nr. Fiskal: 810809642
Nr. Biz: 810809642
Email: meli-shpk@hotmail.com
Web:

PCB: 1182004603000144
Ziraat Banka : 2202130100254873

© Copyright Expert Pro SHPK 2007 - 2025

Page 1/1

Në bazë të kësaj shihet qartë se pesha e një bagëtie del të jetë së paku 860kg e që sipas

natyrës së lopëve barrsë për riprodhim është e pamundur pasi që një lopë apo mëshqerrë e tillë nuk mundet të ketë më shumë se 500-550 kg (siç e ka kërkuar edhe vet AK tek Aneksi 1). Kjo peshë mesatare del pothuajse në të gjitha faturat e paraqitura si referenca e që trego se të gjitha janë të shitura si bagëti për therje. Këtë e dëshmojnë shumë mirë edhe **numrat matrikulit** nga disa fatura dhe numra të tillë të verifikuara ku pas verifikimit në data bazën e veterinarëve të AVUK-ut, pothuajse shumica dalin që janë kafshë të therura e jo siç i ka shënuar ky OE lopë riprodhuese. Kjo ligjërisht konsiderohet mashtrim nga ana e këtij OE dhe shkelje e nenit 65 të LPP-së pasi që në të njëjtën kohë ka shkelur plotësisht Deklaratën nën Betim. Mjafton të shihet edhe lista e kontratave me kujdesë ku vërehet se këto fatura fillojnë nga data 26.11.2024 e vazhdojnë deri më 05.01.2025 që tregon se kjo është përgatitur dhe manipuluar vetëm pasi ka dalur publikim i njoftimit paraprak të prokurimit nga ana e AK-së. Para kësaj date e ka të paraqitur vetëm një kontratë e cila realisht është kontratë për furnizim me mish ndërsa në lisë është paraqitur si kontratë për shitblerjen e lopëve dhe viçave kurse edhe referenca është manipuluar duke e ndryshuar natyrën e kontratës. Ja si duket kontrata dhe referenca:

KONTRATE PER SHITJEN - FURNIZIMI ME MISH

1.Meli Shpk,NUI 810809642,me seli ne Rr.Armend Daci nr.13/1 Prishtine (ne tekstin e metejme:shitesi),ne njeren ane dhe

2.Xhoshkun Drangoj B.I. NUI 810599425,me seli ne Prizren,11 Enver Haradinaj (ne tekstin e metejme: bleresi).

Palet e lartecakura lidhin kete kontrate:

Neni I

Palet kontraktuese kane detyrime ndaj njera-tjetres ne zbatimin e shitblerjes se kafsheve-viqave.

Neni II

Sasia e cila percaktohet ne kete kontrate eshte 30% te furnizimit me kafshe-viqa mish nga therrtorja Meli shpk perafersisht 70 viqa (600-700 kg),e aq sa eshte ne gjendje te prodhoj fermeri brenda nje viti,te cilat ja shet Therrtores Xhoshkun Drangoj B.I. e cila merret me perpunimin e mishit te fresket.

Neni III

Kontrata vlen deri me.31.12.2028

Bazuar në kërkesën e ndërmarrjes "**MELI SHPK**" nga Prishtina të datës 01.07.2025
Xhoshkun Drangoj B.I. lëshon këtë:

REFERENCE

Duke u bazuar në kontratën e nënshkruar në mes të Xhoshkun Drangoj B.I. dhe Meli shpk për shitblerjen e kafsheve – vjqave

Vlera e kësaj kontrate është në bazë të shitblerjes dhe çmimit të tregur vlera për tri vitet e fundit është : **2,964,774.00€**
Furnizimet janë kryer sipas standardeve të përcaktuara në kontratë.

Atëherë vlerësojmë se **MELI SHPK** nga Prishtina i ka përmbushur me përpikëri afatet kohore, aspektet sasiore dhe kushtet cilësore të përcaktuara në kontratë.

Referenca lëshohet me kërkesën e Operatorit Ekonomik dhe mund të shërbejë si dëshmi për pjesëmarrje në tenderët e ardhshëm edhe në institucionet publike të Kosovës.



Në këtë rast përpos që nuk kemi të bëjmë me paraqitje reale në listë të kontratave, kontrata e tillë është akoma aktive dhe se s'ka të drejtë aspak të merret si kontratë e pranueshme pasi që nuk ka përfunduar akoma.

Pavarësisht kësaj, paraqitja e faturave me të dhëna mashtruese siç janë ato të lopëve për riprodhim konsiderohet shkelje e rëndë e ligjit të prokurimit por konsiderohet edhe vepër penale sipas LPRK-së si dhe sipas ligjit të ATK-së. Këtë e vërteton shumë edhe fakti që të gjitha këto fatura të paraqitura janë për lopë riprodhuese ndërsa njësia matëse e shitjes është kilogrami. Kjo tregon qartë se bagëtitë e shitura me kilogramë janë bagëti për therje e jo bagëti për riprodhim. Një element tjetër e tregon edhe pesha mesatare e tyre e cila u përgjigjet plotësisht bagëtitë për therje. Ne do ta paraqesim këtë rast edhe tek organet tjera mbikëqyrëse dhe hetuese që merren me çështjet e tilla sepse kjo është një mashtrim që meriton të hetohet dhe gjykohet. Për këtë i kërkojmë edhe OSHP-së që të angazhojë edhe një ekspert teknik veteriner i cili do bëjë verifikimin e numrave të matrikulit për të gjitha bagëtitë e shitura gjoja si bagëti riprodhuese. LPP e saktëson qartë se kur një OE jep informata përmbajtësisht të rreme dhe mashtruese, duhet eliminuar menjëherë nga konkurrenca dhe

duhet kërkuar edhe nga OSHP që të merren masa ndëshkuese ndaj tijë. Këtë AK nuk e ka bërë andaj kërkojmë nga OSHP që të merr masat e duhura për ta kthyer procedurën në fjalë në parametra real dhe ligjorë. Nisur nga kjo kërkojmë nga OSHP që të bëjë verifikim të faturimeve të tilla dhe më pas të kthej lëndën në rivlerësim. Aq sa është ndryshimi (*tejkalimi jonë*) në buxhet është edhe rritja mujore e çmimeve të tregut në fushën përkatëse andaj është normale që të kemi ndryshim të buxhetit të planifikuar kur dihet se planifikimi i tillë është bërë në fund vitin e kaluar duke u bazuar në çmimet e tregut të atëhershëm.

Nisur nga sa u tha deri më tani, del që pranimi i këtij OE si tenderues i rregullt e shtynë AK-në drejt një vlerësimi shumë joprofesional i cili është në kundërshtim të plotë me kërkesat e nenit 59 të LPP-së ndërsa eliminimi i tenderit tonë me arsyen e tillë del të jetë në kundërshtim me realitetin, çmimet e tregut si dhe në kundërshtim ne nevojat vet AK-së të vendosura tek Aneksi 1 i dosjes së tenderit. Përpos kësaj eliminimi jonë është në kundërshtim edhe me nenin 1, 6 dhe 59 të LPP-së që tregon qartë se AK gjatë administrimit me procedurën në fjalë, përpos tjerash ka shkelë plotësisht nenet e cekura më sipër.

4. AK ka shkelur nenin 60 të LPP-së pasi që nuk ka respektuar kërkesat e dosjes së tenderit të vendosura në përputhje me LPP-në dhe si pasojë e kësaj ka shpërblyer me kontratë një OE që posedon çmim më të ulët por është i papërgjegjshëm. Kjo konsiderohet shkelje e plotë e të gjitha dispozitave që flasin për administrimin e drejtë të parasë publike si dhe konsiderohet shkelje e plotë edhe e kriterit të vlerësimit i vendosur në përputhje me nenin 60 të LPP-së që OE fillimisht duhet të vlerësohen për përgjegjshmërinë e mandej për çmimin. Ja si e përshkruan këtë detyrim të AK-së neni 56.1 i LPP-së:

Neni 56

Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

1. Të gjitha kontratat publike do të jepen, sipas procedurave të themeluara për një seleksionim të tillë, dhe përmes:

1.1. së pari, vlerësimit të tenderëve dhe kandidatëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuar në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit sipas paragrafit 2. të nenit 51 të këtij ligji, dhe tenderëve sipas specifikimeve teknike të kërkuara në bazë të nenit 28 të këtij ligji;

1.2 së dyti, vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kriterëve të vendosura në nenin 60 të këtij ligji.

5. AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së Nr. 04/L-042, pasi që nuk ka respektuar kriteret dhe kërkesat e veta të parashikuara sipas paragrafit 2.2.1 të këtij neni sepse OE i shpallur fitues nuk ka dëshmi të mjaftueshme për të dëshmuar se e plotëson kriterin e tillë. Nisur nga kjo del edhe konstatimi se AK nuk ka respektuar kërkesat e veta nga FDT që përkojnë me shkelje të nenit 69 të LPP-së mbi bazën e të cilit janë vendosur si kërkesa për OE.

Nisur nga gjendja faktike në tenderin në tenderin tonë, nisur nga gjendja në tenderin e OE të shpallur fitues, si dhe nisur edhe nga krejt ato që thamë me lartë për gabimet dhe AK-së dhe mangësitë e konkurrentit tonë, kërkojmë nga OSHP që të marr:

V E N D I M

APROHOHET si e bazuar ankesa e OE “Apetit SH.P.K.” lidhur me tenderin “**Furnizim për blegtori(Subvencione për blegtori) Furnizim me mëshqera Llot-1**” i iniciuar nga **KOMUNA E PODUJEVËS**.

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK - **KOMUNA E PODUJEVËS** dhe lënda të kthehet në **ri-vlerësim**.

Ri-vlerësimi të bëhet plotësisht duke u bazuar në dispozitat ligjore të LPP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit e që realisht më pas do duhej që **FITUES** të shpallej OE “**Apetit SH.P.K.**”.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t’iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale që na shkaktohen nëse ne nuk e marrim këtë kontratë janë të konsiderueshme si në fushën financiare, fitime të munguara, dhe mos mundësi e kompensimit të shpenzimeve përgatitore për këtë kontratë.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

-  1 Njoftim per Kontrat
-  2 Template per Dosja e Tenderit - meshqerat Ri-tenderim
-  3 Specifikat per Mëshqerra - 2025 LLOT 1
-  4 Procesverbali i hapjes se tendereve
-  5 Njoftim mbi vendimin e AK
-  6 Kërkesë për rishqyrtim - KK PODUJEVE - APETITI 19.08.2025
-  7 Vendimi per refuzim te kerkeses per rishqyrtim
-  8 Lista e kontratave dhe disa kontrata e referencia
-  9 Faturat e shitjes dhe transaksionet bankare te paraqitura si referencia

Vërejtje: Të gjithë materialin në të cilin i kemi mbështetur pretendimet e gjeni të bashkangjitur ndërsa ofertën tonë e gjeni në materialin e procedurës së prokurimit që ndodhet në e-Prokurimit!